



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK



Rregullorja Komunale nr.5/2009

RR E G U L L O R E
PËR
LEJE PUNE TË SUBJEKTEVE AFARISTE

Junik,
Korrik, 2009

Duke u bazuar në nenin 12 pika 12.2 shkronja c të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale ,neni 38 të Ligjit mbi tregëtinë e brendshme, udhëzimit administrativë 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste , nenit 20 pika 20.1 shkronja c të Statutit të Komunës së Junikut dhe të Rregullores për Tarifat dhe ngarkesat komunale , Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e vetë të mbajtur me datë: 28.07.2009, miratoi :

R R E G U L L O R E N **PËR LEJE PUNE TË SUBJEKTEVE AFARISTE**

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për lëshimin e lejes së punës, për punë për shoqëritë tregtare dhe subjektet ekonomike që ofrojnë shërbime e që janë të regjistruara sipas Ligjeve në fuqi mbi Shoqëritë Tregtare.

Definicionet dhe kuptimi i termave

Neni 2.

Secili prej termave në vijim, kudo që përdoret në këtë rregullore, do të ketë kuptimin e dhënë, përveç nëse konteksti brenda të cilit një term i tillë paraqitet, nënkupton qartë diçka tjetër:

- Emërtimi “Subjekt afarist”, sipas kësaj Rregulloreje nënkupton secilin person juridik që merret me aktivitete ekonomike të mbështetura në ligj me qëllim përfitimi.
- Organi Kompetent Komunal, nënkupton Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa.

Neni 3

3.1. Subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë afariste në territorin e Komunës së Junikut, duhet të jenë të regjistruara sipas Ligjit mbi regjistrimin e biznesit në Kosovë

3.2. Subjekti që ushtron veprimtari biznesi brenda Komunës së Junikut duhet:

- (a.) Për ndërmarrjen amë dhe për secilën njësi të ketë lejen e punës për ushtrim të biznesit.

(b.) Leja e punës ka karakter personal dhe nuk mund të bartet në personin e tretë.

3.3. Të gjitha aktivitetet afariste ekonomike në Komunën e Junikut, duhet të kryhen në vend të caktuar dhe të përshtatshëm.

3.4. Asnjë subjekt afarist sipas kësaj Rregulloreje nuk lejohet të ushtrojë veprimtarinë e vet afariste pa Leje pune të lëshuar nga Organi Kompetent Komunal.

Neni 4.

Subjekti afarist i cili i plotëson kushtet sipas nenit 3 të kësaj Rregulloreje , është i obliguar që të bëjë kërkesën për marrjen e lejes së punës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pajisjes me certifikatën për ushtrimin e biznesit, të lëshuar nga MTI-a (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë).

Neni 5.

Për marrjen e Lejes së Punës të gjitha subjektet afariste janë të obliguara të sigurojnë dokumentacionin:

1. Certifikatën e biznesit të regjistruar.
2. Lejen e ndërtimit.
3. Lejen për shfrytëzimin e objektit afarist me karakter të përkohshëm ose të përhershëm.
4. Lejen për shndërrimin e objektit të banimit në objekt afarist.
5. Lejen poseduese me kopje të planit.
6. Kontratën mbi shfrytëzimin e tokës ndërtimore.
7. Kontratën nëse objekti afarist është dhënë me qira.
8. Plotësimi i kushteve higjieno-teknike të objektit afarist.
9. Dëshminë se i ka paguar të gjitha obligimet paraprake ndaj buxhetit komunal.
10. Licencën e subjektit afarist të lëshuar nga ministria gjegjëse (për ndërmarrjet prodhuese, përpunuese dhe finalizuese - fabrikat, dhe subjektet tjera).

Neni 6.

Organi Kompetent Komunal, pas marrjes së kërkesës dhe konstatimit se kërkesa i ka të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas nenit 5. në afat prej 30 ditësh merr aktvendimin meritor. Nëse pala ka vërejtje ndaj aktvendimit të Organi Kompetent Komunal në afat prej 15 ditësh mund të ushtrojë ankesë pranë Zyrtarit të Lartë Ekzekutiv (Kryetarit të Komunës), e nëse pala edhe me aktvendimin e Kryetarit të

Komunës është e pakënaqur ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh ti drejtohet MTI – Departamentit të inspeksionit.

Neni 7

Leja e punës ka karakter të përhershëm dhe do të vlejë nga data e lëshuarjes. Ripërtrirja e lejes së punës bëhet nëse ndryshohet veprimtaria e subjektit afarist , adresa , pronari etj.

Neni 8

Leja e Punës është e pa vlerë në këto raste:

- a). Kur subjekti e bënë çregjistrimin e veprimtarisë afariste , dhe
- b). Nëse Leja e Punës është lëshuar në kundërshtim me nomenklaturën përkatëse të veprimtarive afariste.

Neni 9

Subjekti afarist është i obliguar që Lejen e Punës ta vendos në një vend të dukshëm në lokalin afarist.

Neni 10

Leja e punës mund të përdoret vetëm për destinimin e dhënë.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 11

11.1. Nëse inspektori i tregut me rastin e kontrollit inspektues konstaton se subjekti afarist nuk ka Leje të Punës, personit përgjegjës i tërhiqet vërejtja dhe kërkohet nga ai që në afat prej 15 ditësh ta siguron Lejen e Punës.

11.2. Po qe se i përmenduri në afatin e cekur në alinenë 1. nuk e ka përmbushur këtë detyrim, ndaj tij inicohet procedura e kundërvajtjes pranë Gjykatës Komonale për Kundërvajtje në Deçan si Gjykatë kompetente lëndore dhe territoriale për vendosje të kësaj çështje.

11.3. Lartësia e dënimit është 100.00 €.

11.4. Nëse edhe pas marrjes së masave të caktuara në alinenë 1, 2 dhe 3 të këtij neni subjekti përgjegjës nuk e siguron Lejen e Punës, personat përgjegjës të Organit Kompetent Komunal do të iniciojnë procedurën për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 12

Implementimin e kësaj Rregulloreje do t' a bëjë Organi Kompetent komunal përmes Shërbimit të inspektionit pranë Drejtorisë së Shërbimeve publike dhe Inspektion.

Dispozitat kalimtare

Neni 13

Për të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore vlejnë Dispozitat e Ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Neni 14

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregullore bëhet në procedurën e njëjtë sikurse për aprovimin e saj.

Neni 15

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e miratimit të saj nga ana e Kuvendit Komunal në Junik.

KUVENDI I KOMUNËS SË JUNIKUT

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal
Zelfishahe Shala**

Datë: 28.07.2009

Nr. _____